



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.04.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "KFP_DDD", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-2227-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-027-221, **nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatori Ekonomik "KFP_DDD" e dt.11.04.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-2227-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-027-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 13.03.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 13.03.2024;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "KFP_DDD", me dt.11.04.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinsektimi dhe Deratizimi në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-2227-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-027-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 16.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj se Komuna e Gjakovës ka sipërfaqe të vogël e janë të mjaftueshëm vetëm 2 automjete apo kamion, nuk qëndron sepse Komuna e Gjakovës ka sipërfaqe mjaft të madhe dhe në administrimin e saj i ka 87 fshatra.

Autoriteti Kontraktues, ka vepruar në harmoni të plotë me LPP-në dhe me RRPP dhe në konsultime me kërkesat, ku mund të sqarojmë se dritat rotative sinjalizuese janë të domosdoshme për siguri në rrugë dhe identifikim të lehtë nga qytetarët, po ashtu AK konsideron se dritat rotative nuk janë kushte diskriminuese pasi që mund të gjenden lehtë në tregun e Kosovës.

Pretendimit juaj i dytë nuk qëndron, sepse të gjitha kërkesat janë në harmoni me nenin 7 dhe 28 të LPP-së, pasi që të gjitha pajisjet e kërkuara përmes dosjes së tenderit janë të domosdoshme për kryerjen sa më efikase dhe më të shpejtë të shërbimeve të kërkuara. Të gjitha kërkesat janë të domosdoshme dhe minimale për të siguruar cilësinë e nevojshme për realizimin e DDD në qytetin e Gjakovës. Këto kërkesa janë të përpiluara në bazë të përvojave më të hershme duke u bazuar në:

Hapësirat për kryerjen e shërbimit, konfiguracionin, kohëzgjatjen prej 3h (20:00 – 23:00) 2 ditë, lumenjtë brenda qytetit, ngarkesa apo stërngarkim i trafikut në sezona dhe të gjitha këto karakteristika janë marrë për bazë për të përpiluar këtë kërkesë.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Të gjitha palëve të interesuara;

Faton Gufaj
Menaxher i Zyrës së Prokurimit

